



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË MEMALIAJ

Nr. 1161/2 prot.

Memaliaj më 28.05.2025

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 28.05.2025 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në katin e parë të bashkisë Memaliaj.

Mbledhja drejtohet nga kryetari i këshillit Z. Erjon Sinanaj.

Ora e fillimit të mbledhjes 10:00.

Në momentin e fillimit të mbledhjes janë të pranishëm 10 këshilltarë.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të hapur.

● Pika e parë e rendit të ditës

- Miratimi i rendit të ditës

Njihen këshilltarët me rendin e ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.04.2025

3. Informacion mbi vendimet e marra në mbledhjen e datës 29.04.2025.

4. Projekt vendim: "Për ndryshimin në përbërjen dhe strukturën e komisionit të financës.

5. Projekt vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për periudhën 1-30 prill 2025".

6. Projekt vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin maj 2025".

7. "Projekt vendim: "Për sponsorizim për vendosjen e bustit të Petrit Rukës"

8. Raporti vjetor i auditit.

9. "Projekt vendim:

"Për miratimin e propozimit të bashkisë Memaliaj për një ndryshim në buxhetin e vitit 2025".

10. "Projekt vendim: "Për miratimin e projektit me objekt " Riparim i shkarjeve në rrugën e fshatrave : Martalloz , Lagjia Meçaj, Lulëzim, Fahat Memaliaj".

11. Projekt vendim; "Për miratimin e parashikimeve afatmesme të të ardhurave dhe teveneve përgatitore për PBA 2026-2028 "

12. Projekt vendim: "Për miratimin e sipërfaqes së tokës bujqësore që do të jepet me qera"

13. Raporti vjetor i zbatimit të buxhetit për vitin 2024".

Vjen në mbledhje Znj. Lauresha Lila.

Hidhen rendi i ditës në votim.

Vota Pro 11 vota

Vota Kundër 0 vota

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

- Pika e dytë e rendit të ditës.

- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.04.2025.

Hidhet në votim.

Vota Pro 9 vota

Vota Kundër 0 vota

Vota Abstenim 3 vota. Miratohet. Arsyeja nuk kanë qenë në mbledhjen e kaluar.

- Pika e tretë e rendit të ditës. Informacion mbi vendimet e mbledhjes së datës 29.04.2025 sipas shkresës së prefekturës.

- Pika e katërt e rendit të ditës.

- "Për një ndryshim në komisionin e financës ", pasi ka dhënë dorëheqjen z.Anest Halili nga kryetar komisioni.

Diskutime: Z. Xhevit Kacorri: Ky komision ka më shumë ngarkesë edhe komisioni i arsimit ku unë bëj pjesë. Shpresoj që të gjithë komisionet të bëhen me 5 anëtarë për një mbarëvajtje sa më të mirë.

A. Muçoima: Anesti ka dhënë dorëheqje edhe si anëtarë apo vetëm si kryetar?

Vjen në mbledhje Z. Bujar Mamaj.

Esmerald Xhemali: Në komision është dhe një sekretar kështu që duhet përcaktuar në vendim.

Kryetari Z.Erjon Sinanaj: Propozoj Znj.Edmonda Harizi të kalojë në pozicion e kryetares.

Petrit Lumani: Propozoj Znj.Afize Sula si anëtare.

Flamur Mushamati: Propozoj të gjitha komisionet të bëhen me 5 anëtarë dhe propozojë nga opozita Znj.Lauresha Lila.

Petrit Lumani: Propozoj si sekretar komisioni Z. Bujar Mamaj.

I pranishëm në mbledhje Z.Albert Kasi koordinatori i BtF, ka një fjalë përshëndetëse dhe i sqaron këshilltarët për rëndësinë e raportit të komisionit.

Hidhet në votim projekt vendimi.

Vota Pro 12 vota

Vota Kundër 0 vota

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

- Pika e pestë e rendit të ditës:Projekt vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për periudhën 1-30 prill 2025". Relaton Znj. Laora Hoxha sipas relacionit bashkangjitur.

Hidhet në votim.

Vota Pro 11 vota

Vota Kundër 0 vota

Vota Abstenim 1 votë. A. Halili. Miratohet.

- Pika e gjashtë e rendit të ditës. Projekt vendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin maj 2025".

Relaton Znj. Laora Hoxha sipas relacionit bashkangjitur.

Hidhet në votim.

Vota Pro 10 vota

Vota Kundër 0 vota

Vota Abstenim 1 votë. A. Halili. Miratohet.

Esmerald Xhemali nuk mori pjesë në votim.

- Pika e shtatë e rendit të ditës. "Projekt vendim: "Për sponsorizim për vendosjen e bustit të Petrit Rukës".Relaton Z. Besnik Caushi/Drejtor i financës sipas relacionit bashkangjitur.

Diskutime: Bujar Mamaj: Jemi dakord me projektvendimin sepse Z. Petrit Ruka është një figurë që kapërcen krahinën tonë ka vlera kombëtare vepra e tij. Propozoj të paktën 100.000 lekë të reja për figurën e Z. Petrit Ruka.

Esmerald Xhemali: Në lidhje me pikën 7, ky propozim ka ardhur nga shoqata Labëria. Ky do të vendoset ky bust?

Z. Erjon Sinanaj: Sipas kërkesës së shoqatës janë të përcaktuara se ku do të vendosen ku do të vendoset në dokumentacionin shoqëruar.

Esmerald Xhemali: Unë kam një mendim të mos sponsorizojmë sepse jemi bashki e varfër le ta bëjë bashkia Tepelenë duke qenë se ka të ardhura më të mëdha.

Asqeri Muçoima: Jam dakord për projektvendimin por jam në dijeni që do të vendoset edhe bustit i Tafil Buzit edhe ne kemi përgjegjësinë më të madhe duke qenë se është i bashkisë sonë.

Xhevit Kacorri: Gjithësecilit i shkon gjuha ku dhemb, dhëmbi. Këto figura duhen nderuar por të flasim konkretisht për projektvendimin.

Esmerald Xhemali: Për procedurë e kërkuar fjalën Z. Kryetar, të zbatohet rregullorja, jo një këshilltarë 4 herë ta marri fjalën dhe të tjerët të mos flasin fare.

Flamur Mushamati: Jam dakord për projektvendimin, për sponsorizim e vendosjes së bustit të Z. Petrit Rukës.

Taulant Rama: Mua personalisht më pëlqen që figurat e vlerësuara në rang kombëtar të vlerësohen edhe nga krahinat nga vijnë. Për procedurë dua dhe konfirmimin e drejtorit të Financës a mundet ta sjelli projektvendimin me 100 000 lekë se me 50 000 më duket ulje.

Besnik Caushi/ Drejtor finance: Drejtori i financës duhet të marri konfirmimin nga titullari i institucionit.

Kryetari fton ta votojnë projektvendimin me ndryshime nga 50 000 lekë në 100 000 lekë të reja.

Vota pro 10 vota

Vota Kundër 3 vota E. Xhemali, A Muzha, L. Lila.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

• Pika tetë e rendit të ditës. Raporti vjetor i auditit.

Vjen në mbledhje Znj. Merzine Bega për kërkesën e bërë para 1 viti për ndihmë financiare për rastin e fatkeqësisë së humbjes së jetës së dy familjarëve në aksident automobilistik.

Besnik Caushi/ Drejtor finance: Një arsye e mos marrjes në shqyrtim ka qenë se djali i kësaj familjeje jeton jashtë vendit. Mua më vinë shumë kërkesa dhe nuk mund t'i ndjek dhe zgjidh të gjitha.

Xhevit Kacorri: Ne kemi pasur praktika të tilla dhe sygjeroj të përfshihen sepse kanë kontribuar në këtë qytet për shkak të fatkeqësi së ndodhur këtyre dy familjarëve, një fatkeqësi që ka tronditur gjithë komunitetin memaliot.

Asqeri Muçoima: Jam dakord ajo nuk ishte një fatkeqësi, ishte një tragjedi për atë familje. T'ia lehtësojmë sadopak dhimbjen.

Taulant Rama: Duke qenë se jemi në komunikim verbal, nuk e di pse nuk është marrë në shqyrtim nga administrata. Kemi një tragjedi familjare që ka krijuar një traumë në këtë qytet. I ndjeri ka qenë ish futbollisti, ish këshilltarë. Unë propozoj nëse ky rast nuk merret në shqyrtim të mos kalojë asnjë kërkesë tjetër.

Esmerald Xhemali: Unë dua të kërkoj ndjesë për ripërsëritjen, ne këtë debat e kemi bërë dhe herë tjetër. Dua që këshillit t'i japi llogari komisioni i shqyrtimit të kërkesave. Jam dakord me propozimin e kolegut dhe i bëj thirrje kryesisë të mos pranojë këto projektvendime në rend dite.

Erjon Sinanaj: Ju drejtori i financës dhe ju sekretare e Këshillit e keni detyrë të njoftoni kryetarin e bashkisë ose një nga nënkryetarët të jenë të pranishëm në mbledhjen e radhës ashtu siç e përcakton ligji.

Petrit Lumani: Jam dakord të jenë këtu të pranishëm titullarët dhe të jepen informacione të qarta.

Xhevit Kacorri: Dua të gjitha kërkesat të vinë dhe në këshill.

Bujar Mamaj: Dua të prononcohem dhe për një rast tjetër. Përparim Mema ka bërë një kërkesë për gruan e tij znj. Ermira Mema sepse e ka operuar nga një sëmundje e rëndë. Ju lutem merrni parasysh këtë rast.

Besnik Caushi: Çdo kërkesë është bërë edhe për dijeni këshillit, disa nuk kanë as adresë as numër telefoni.

Znj. Afize Sula: Pse ia sekreton kërkesën kur nuk ka të dhëna të sakta pasi kërkesa është tip dhe i kërkon të gjitha këto të dhëna që citove.

Kryetari i këshillit kërkon 5 minuta pushim.

Fillon mbledhja me pikën 8 të rendit të ditës.

Z. Fredi Kalemi / Auditimi : Relaton sipas materialit bashkangjitur.

Petrit Lumani: Çfarë përfshinë auditimi?

Fredi Kalemi: Auditimi është kompleks.

Esmerald Xhemali: Në material shoh vetëm vitin 2023. Kjo është bërë me përzgjedhje.

Fredi Kalemi: Auditimi është me plan , disa janë me detyrim.

Esmerald Xhemali: Sektori i tatim taksave, nuk pashë gjë cilat janë rekomandimet dhe sa ishin zbatuar, asnjë informacion mbi realizimin e tyre. Ndërmarrja e shërbimeve publike dhe Futboll Klub e ke trajtuar si shoqatë. Po prokurimet e bashkisë nuk janë audituar nga ana juaj ? Njësia e auditimit vazhdon të jetë vakancë, këtu thua grupi i auditimit .

Asqeri Muçoima: Nga auditimi që ke bërë, a ka pasur shkelje ligjore dhe ku ?

Fredi Kalemi: 1. Te sporti nuk ka një plan shpenzimi , kam lënë 18 rekomandime . Sporti është institucion me risk të lartë . Tek shërbimet është lënë detyrim arkëtimi.

Erjon Sinanaj: Këtu jemi në një auditim të përgjithshëm. Nëse ka kërkesa të lihen me shkrim dhe të vij përsëri për pyetjet që keni.

Xhevit Kacorri: Fillimisht do të isha i kënaqur që ky material të ishte i firmosur i vulosur. Do të doja të dija dhe kush kishte punuar mirë . Kurumi i komisionit të ekonomisë nuk u bë sepse ai do të vinte pikën mbi i. Sport klub Memaliaj thotë detyrimet e 2023 . Sporti ka një specifikë, auditimi bëhet për 2 muajt që ka aktivitet. Ju e keni shkurtuar kohën e auditimit. Unë kam evidentuar një ndërhyrje që ka bërë bashkia. Pse nuk janë evidentuar të gjitha? Me sa shohë mbetet një vlerë 7 mil lekë dhe pastaj i paguan 3 mil bashkia. N.q.se bashkia paguan ka gjetur një shoqatë. Cila është kjo shoqatë?

Fredi Kalemi: Unë kam të drejtë ta evidentojë dhe pasqyrojë . Është e drejtë apo jo këtë nuk e di.

Xhevit Kacorri: Kërkoj një takim të dytë në muajin gusht të vij informacion i detajuar. Për të pasur një përfshirje të:

- 1.Bilanci i sportit.
2. Vendimi i gjykatës me anëtarët e asamblesë.
3. Lista e sportistëve të federuar së bashku me listëpagesën.
4. Struktura e klubit dhe Struktura financiare e firmosur nga anëtarët e asamblesë.

Taulant Rama: Nëse e keni interpelancë Z. Kryetar lini një mbledhje tjetër. Largohet nga mbledhja Znj. Afize Sula.

Në auditimin e radhës të futet dhe drejtoria e financës dhe drejtoria e shërbimeve. Unë e kam propozimin të sillët auditimi për gjithë bashkinë i detajuar.

●Pika nëntë e rendit të ditës:"Projekt vendim:"Për miratimin e propozimit te bashkisë Memaliaj) për një ndryshim në buxhetin e vitit 2025".

Relaton Z. Besnik Caushi sipas relacionit bashkangjitur.

Largohet nga mbledhja Znj. Arsola Muzha.

Esmerald Xhemali: Ky projekt vendim mban datën e muajit të kaluar. Në mbledhjen e kaluar kemi kërkuar një projekt për rrugën.Dua preventiv dhe specifikimet teknike. Personalisht deklaroj votën time kundër dhe u bëj thirrje kolegëve të vendosim standarde. Unë i dua 5 ditë para materialet e kërkuar në mbledhjen e komisionit muajin e kaluar.

Vjen në mbledhje Znj.Afize Sula.

Xhevit Kacorri:Unë propozoj të hiqet fjala beton nëpër fshatra. Ato rrugë që bëhen të bëhen me asfalt.

Bujar Mamaj: Nuk kemi informacion për këtë shpërndarjen e investimeve në bashkinë Memaliaj. Të bëhet një shpërndarje e drejtë e këtyre investimeve në bashkinë Memaliaj. Jo të gjitha investimet të shkojnë në fshatin Kalivaç . Të bëhet dhe rruga e fshatit Kashisht.

Petrit Lumani: Unë propozoj të bëhet edhe rruga e fshatit Kamçisht. Jo të gjitha në Kalivaç.

Xhevit Kacorri: Kam edhe unë një propozim të bëhet rruga e lagjes Memaliaj qytet që lidh dy rrugët që dalin te sheshi i qytetit Tani në verë që mbyllen rrugët vështirësohet qarkullimi.

Taulant Rama: Nevoja ka më shumë sesa investime . Banorët e fshati Kamçisht po bën një rrugë me iniciativën e tyre. Pse mos të shkoj ky buxhet atje dhe kjo rrugë të përfundojë.

Asqeri Muçoima: Kur unë ngrita shqetësimin kur miratuam prioritetet, tani jemi peng i prioriteteve që miratuam. Administrata ka sjellë projektvendimin, unë isha i mendimit që çdo tepriçë të qëndrojë në njësinë përkatëse. Nuk është hera e parë që mungon dokumentacioni shoqërues. Meqë ndodhemi në këto kushte pyetja ime është: Sa kohë ju duhet ta plotësoni?

Kryetari propozon ta hedhim në votim.

Vota Pro 3 vota

Vota Kundër 3 vota

Vota Abstenim 4 vota. Nuk miratohet.

• Pika dhjetë e rendit të ditës: "Projekt vendim: "Për miratimin e projektit me objekt " Riparim i shkarjeve në rrugën e

fshatrave : Martalloz , Lagjia Meçaj, Lulëzim, Fshat Memaliaj".

Relaton Z. Petrit Hoxha/ topograf sipas relacionit bashkangjitur.

Asqeri Muçoima: Unë do të doja asistencë juridike. A duhet të kalojnë këto projektvendime në komision?

Çfarë duhet të bëjmë në këto raste kur nuk janë trajtuara në komision? Këto punime janë urgjente besoj.

Petrit Hoxha: Në lagjen Meçaj duhet bërë mur mbrojtës dhe kanal kullues.

Esmerald Xhemali: Unë nuk shoh emergjencë nga fotot bashkangjitur. Ku është rreziku i rrëshqitjes? Nga fotot duket vetëm një ferr e pa prerë. Ju e quani emergjencë këtë?

Xhevit Kacorri: Një qytetar ka bërë një kërkesë para një viti, dua të di pse nuk është marrë parasysh në fshatin Kalivaç.

Anest Halili Rruga në fshatin Toç duke nisur nga shtëpia e administratorit është gërryer nga përroi , njerëzit po kalojnë nëpër toka. Ju lutem ta shihni tek emergjencat .

Hidhet në votim.

Vota Pro 8 vota.

Vota Kundër 0 vota

Vota Abstenim 3 vota . Esmerald Xhemali, Anest Halili, Afize Sula. Miratohet.

• Pika njëmbëdhjetë e rendit të ditës: Projekt vendim; "Për miratimin e parashikimeve afatmesme të të ardhurave dhe tevanëve përgatitore për PBA 2026-2028 ". Relaton Z. Besnik Caushi sipas relacionit bashkangjitur.

Anest Halili: Tek pika 2 është 25-27. Cila duhet të jetë? Korrigojeni 26-28.

Xhevit Kacorri: A ka ndonjë pikë referimi për mbetjet e ngurta?

Hidhet në votim.

Vota Pro 9 vota

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Esmerald Xhemali nuk merr pjesë në votim.

• Pika dymbëdhjetë e rendit të ditës. Projekt vendim: "Për miratimin e sipërfaqes së tokës bujqësore që do të jepet me qera".


Esmerald Xhemali: Dua të di: A është pajisur bashkia me certifikatë pronësie sipasligjit për këto numra pasurie?

Beqar Xhaferi: Nëse prona nuk certifikohet nga ana e bashkisë, nuk lidhet kontrata pranë noterit.

Petrit Lumani: Ato toka që kërkon të jepni me qera , sot rezultojnë të mbjella. Si do të procedohet? Unë kam shkuar me komunitetin dhe i kam parë në terren.

Beqar Xhaferi: Ju e dini që po vilen ullinjët dhe nuk pi i vilen taksat nga bashkia sepse nuk ka një kontratë.

Petrit Lumani: A mund të konkurrosh ti? Beqar Xhaferi: Jo nuk mund të konkurrojë sepse është e mbjellë ullinj.



Bujar Mamaj: Para ca kohësh kaluam për emergjencë vend grumbullimin e mbeturinave. Votua Pro, tani na ka dalë pronar.

Hidhet në votim.

Vota Pro 5 vota. Flamur Mushamati, Xhevit Kacorri, Anest Halili, Afize Sula, Taulant Rama.

Vota Kundër 3 vota

Vota Abstenim 2 vota. Nuk miratohet.

●Pika trembëdhjetë e rendit të ditës:" Raporti i buxhetit për vitin 2024.

Relaton Z. Besnik Caushi sipas materialit bashkangjitur.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Këshilltarë pjesëmarrës:

1. Afize Sula
2. Anest Halili
3. Lauresha Lila
4. Asqeri Muçoima
5. Taulant Rama
6. Xhevit Kacorri
7. Arsola Muzha
8. Esmerald Xhemali
9. Flamur Mushamati
10. Petrit Lumani
11. Bujar Mamaj
12. Erjon Sinanaj

13. Malton Bex

Sekretari i Këshillit
Erjola Allka

Erjola Allka



Kryetari i Këshillit
Erjon Sinanaj

Erjon Sinanaj